



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 15.06.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Rrustem Mustafa, Arben Gashi, Valdete Bajrami, Vjosa Osmani, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Luljeta Veselaj- Gutaj, Kujtim Paçaku dhe Slllobodan Petroviq.

Mungoi: Xhavit Haliti.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky

R E N D I D I T Ë S:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutimi i Kreut VI (nenet nga 13 deri 17) të nismës legislative për projektligjin për Kuvendin e Republikës së Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetarja pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen sipas këtij Rendi të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

- 2. Diskutimi i Kreut VI (nenet nga 13 deri 17) të nismës legislative për projektligjin për Kuvendin e Republikës së Kosovës.**

Kryetarja - I njoftoi se nga Komisioni për Integritet është kërkuar të shqyrtohet vetëm Kreu VI, nenet nga 13 deri në 17 të nismës legjislative për Kuvendin, duke potencuar se edhe në Raport të Progresit është kërkuar që Kuvendi ta ketë Ligjin e vet. Ky projektligj kur ta kalojë leximin e parë do të na vije prapë për amendamentim. Tani nga ne është kërkuar të shqyrtohen në Komision vetëm këto 4 nene dhe propozoi të fillohet prej nenit 13 dhe të shkohet me radhë. Neni 13 ka të bëjë me Rregullat e përgjithshme të bashkëpunimit dhe hapi diskutimin për këtë nen.

Vjosa Osmani - Propozoi që në paragrafin 1 të këtij neni fjala „ **zbatim**” të zëvendësohet me fjalën **realizim** të interesave. Anëtarët një zëri u pajtuan për këtë ndryshim.

Kryetarja kaloi në paragrafin 2 të këtij neni dhe pyeti se a kanë ndonjë propozim për plotësim dhe ndryshim të këtij paragrafi.

Vjosa Osmani - Tha se Kuvendi e ka tashmë të drejtën e kontrollit mbi Qeverinë lidhur me integritetin në BE duke marrë informacione për mes raportimeve të ministrave dhe nuk e di çka është paraparë diçka e re përtej atyre të drejtave të parapara me Kushtetutë dhe Rregullore dhe ne do të ishte mirë me propozuar diçka të re.

Në mandatin e kaluar kjo është bërë pjesë e Planit të Veprimit për MSA-në, ka të bëjë me atë që quhet mandat i negociuar, ose e drejta e Komisionit Evropian që ekziston në parlamentin e Danimarkës dhe është marrë shembull edhe nga Parlamentet e tjera të BE-së, ku për çdo negociatë që e bën Qeveria në procesin e Integritetit Evropian paraprakisht duhet të vijë në Komisionin për integritet evropian të marrë mandat për të negociuar këtë çështje dhe kjo ka shërbyer për fuqizimin e komisioneve për integritet evropian në parlamentet konkrete. Ne në mandatin e kaluar kemi pasur miratim që ky Komision të fuqizohet duke e marrë pikërisht këtë mandat, andaj propozoi që të shtohet edhe një pikë që ka të bëjë me këtë të drejtë shtesë për Komisionin për Integritet Evropian, sepse obligon ministrat përkatës që para se të negociojnë për çështjet e Integritetit Evropian, paraprakisht janë të obliguar që para se të nisen për Bruksel ta marrin një miratim nga Komisioni.

Ilir Deda- Pikërisht për këtë çështje kemi diskutuar edhe me Gizin se çfarë roli do me pasur Kuvendi, a do me pasur rol të tretë, të dytë apo do me pasur rol aktiv të madh, nëse po, atëherë ky komision duhet me u aktivizuar dhe e përkrahi plotësisht me u fuqizuar mandati i këtij komisioni të përcaktuar me ligj.

Rrustem Mustafa-Mendoj se me ligj nuk përcaktohet rregullorja e punës, por është kompetencë e Kryesisë së Kuvendit për të marrë vendime, por kjo çka po kërkohet mundet me u rregulluar me Rregullore të punës me vullnetin politik të Kuvendit.

Valdete Bajrami - Është pro propozimit të Vjosa Osmanit për ta propozuar amendamentin.

Time Kadriaj - Tha se në këtë nen thuhet përveç të drejtave të parapara me Kushtetutë dhe Rregullore dhe nëse duam fuqizimin e këtij Komisioni atëherë duhet ose të riformulohet ose të shtohet paragraf i ri siç u tha.

Kryetarja - Tha se lidhur me nenin 13.2 kemi dy propozime ose të riformulohet paragrafi ekzistues ose të shtohet paragraf i ri, i cili do të përcaktojë që Qeveria para se të fillojë ndonjë negociim apo ndonjë aktivitet me BE-në të vijë në konsultim edhe me komisionin për Integritet, në fakt edhe me marrëveshjen me Serbinë e kemi pasur që Komisionet duhet të jenë pjesë e negociatave. Prandaj nuk po e shoh që mundet diçka me e dëmtuar nëse Qeveria vjen me u konsultuar me Komisionin dhe me i dhënë mandatin.

Vjosa Osmani - Tha se këtu po flasim për çështje shumë specifike të Integritimit Evropian, e jo për negociata mes Kosovës dhe Serbisë e t'i sjellim kryeministrin apo ministrat e të marrin paraprakisht mandatin, sepse ata e kanë marrë në mandatin e kaluar.

Sa i përket rregullores së punës, proceduralisht nuk e harton Kryesia, por Nënkomisioni për mandate dhe imunitete dhe ai miratohet në Kuvend me 2/3 dhe janë anekset me kompetencat e Komisioneve, mirëpo qëllimi i këtij ligji është të parashohë çështjet që nuk janë në Rregulloren e Kuvendit, kurse qëllimi i nenit 13.2 është që t'i japë Kuvendit dhe trupave të Kuvendit kompetenca extra që nuk janë të parapara në Rregulloren dhe në Kushtetutë. Atë që e propozova unë nuk bien ndesh me asnjë dispozitë Kushtetuese dhe Ligji për marrëveshje ndërkombëtare shumë qartë e përcakton kush mundet me negociuar marrëveshje dhe nuk e ndalon një Komision të kontrollojë një dikaster të veçantë qeveritar në qoftë se kemi të bëjmë me procesin e integritimeve evropiane dhe në çfarëdo faze ne, si komision, mundemi me ushtruar kontroll mbi ministrin e caktuar dhe kjo i obligon teknikisht ministrat që para se të nisen në Bruksel të vijnë njëherë në Komision dhe kjo e rritë rolin e Komisionit dhe Kuvendit dhe si rezultat përfundimtar krijon unitet politik në procesin e integritimit evropian, sepse sa herë kemi pasur përfshirje ma të madhe të këtij Komisioni në procesin e integritimeve evropiane, gjithmonë kemi pasur një miratim unanim të proceseve të integritimit edhe në seancë.

Time Kadrijaj - Tha se pajtohet me propozimin e deputetes Osmani që nenit 13 t'i shtohet një paragraf i ri po vlerësoj se në paragrafin 2 duhet bërë një ndërrhyrje, sepse pa kuptim janë fjalët në fillim të paragrafit „përveç të drejtave të parapara me Kushtetutë dhe Rregullore” pra të hiqen këto fjalë dhe të vazhdoj teksti.

Kryetarja konstatoi se anëtarët u pajtuan që në nenin 13, pas paragrafit 2 të shtohet paragraf i ri si vijon;

Komisioni për Integritime Evropiane i Kuvendit të Republikës së Kosovës autorizon paraprakisht qëndrimin negociues të Qeverisë Qeverisë për negociimin e marrëveshjeve që ndërlidhen me procesin e Integritimit Evropian.

Vazhdoi me **nenin 14** dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Vjosa Osmani - Lidhur me paragrafin e parë të këtij neni tha se ka ndodhur edhe në të kaluarën kur ka pas formulime të tilla, si në fillim të paragrafit 1 të këtij neni ku thuhet se „Kuvendi shqyrton rregullisht procesin e bërë në Procesin e Stabilizim Asociimit, ne duhet me e specifikuar a po donë me e përfunduar brenda komisionit përkatës, apo domosdoshmërisht duhet me e përcjellë në seancë dhe me pas votim për secilën çështje, ish dashtë me komisionin që e ka hartuar me u konsultuar se cili ka qenë qëllimi i tyre.

Ilir Deda - Lidhur me këtë tha si shembull është Kroacia, ku në proces të Integritimit ka qenë përgjegjësia e ndarë në dysh dhe në çdo fazë ka qenë këshilli i përbashkët i ekzekutivit dhe i legjislativit, sepse integritimi në BE- nuk është detyrë vetëm e ekzekutivit, por është proces legjislativ dhe ekzekutiv dhe ai është shembulli më i mirë, ma i dobëti mundet me qenë ndonjë vend tjetër në rajon ku Qeveria vetëm me dy fletë informon çka ka bërë, varet prej neve sa jemi ambicioz dhe cilën praktikë duam me e ndjekur.

Vjosa Osmani - Shtoj se nëse çdo gjë kalon përmes seancës brengosem se mos po shkaktohen vonesa, sepse këto kanë me qenë vendime që kanë me u dashtë me u marrë urgjentisht, por megjithatë është e vërtetë nëse gjithçka dërgohet në seancë, atëherë Kuvendi e merr ma seriozisht procesin e integritimeve. Prandaj propozoj që në paragrafin e parë të këtij neni në fillim të fjalisë pas Kuvendi, shtohet fjala „**në seancë**”.

Kryetarja lidhur me nenin 15 filloj me paragrafin e parë dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Vjosa Osmani - Lidhur me këtë pikë, ku thuhet „Qeveria dorëzon në Kuvend për diskutim”tha se edhe kjo nga praktikat e mëhershme duhet me u sqaruar se a duhet vendimi përfundimtar me u votua si rezolutë apo vendim ,a nxjerr diçka ai diskutim apo shkojmë veç me debatuar dhe asgjë tjetër.

Arben Gashi -Tha se vendimi i Kuvendit është mendim i Kuvendit dhe vullnet i Kuvendit, prandaj nëse ne flasim kot në seancë individualisht apo si grupe dhe në fund Kuvendi nuk ka një konkluzion atëherë nuk ka logjikë me u diskutuar për diçka nëse në fund Kuvendi nuk shprehet për të,dhe konkluzionet e Kuvendit nxirren vetëm me votë dhe nuk ka mekanizëm tjetër i cili i nxjerr konkluzion Kuvendit.

Kujtim Paqaku - Tha se nëse një dokument vjen në Kuvend për shqyrtim ai pasi të shqyrtohet ose miratohet ose nuk miratohet, pra duhet të dilet me një vendim për atë dokument.

Kryetarja - Tha se nëse në pikën e parë të nenit 15, ku thuhet Qeveria dorëzon në Kuvend për diskutim dhe ja shtojmë fjalët „**dhe miratim** ” dhe e fshijmë paragrafin 2 në fakt vetëm e fuqizon nenin 14.4.

Nëse Komisioni i cili e ka punuar këtë e ka menduar që këto duhet të vijnë për diskutim atëherë diskutimi duhet ta ketë një përfundim, prandaj diskutimi dhe miratimi do ta plotësojë kërkesën tonë.

Vazhdoi me paragrafët e tjerë dhe për paragrafin 4 anëtarët u pajtuan që të fshihet se e konsideruan si të pa nevojshëm. **Andaj konstatoi se anëtarët u pajtuan që në paragrafin e parë të nenit 15 pas fjalës diskutim** shtohen fjalët „**dhe miratim** vazhdon me heqjen e **paragrafit 2 dhe paragrafit 4,** pastaj vazhdon rirenditja e pikave të cilat pasojnë.

Pastaj e hapi diskutimin lidhur me nenin 16 „Informacioni që Qeveria duhet t’i ofrojë Komisioneve të Kuvendit.

Lidhur me këtë nen nuk kishte propozime për ndryshim.

Kryetarja në vazhdim kaloi në nenin 17 dhe sqaroi se me MSA është kërkuar që të krijohet Komisioni parlamentar për Stabilizim- Asociim dhe lidhur me këtë hapi diskutimin.

Vjosa Osmani- Tha se nëse duhet me u themelua Komisioni parlamentar për Stabilizim-Asociim, ne duhet me i përcaktuar kompetencat e këtij Komisioni dhe Komisionit për Integrim Evropiane, për mos tu duplikuar kompetencat, andaj pika 1 e këtij neni duhet të riformulohet.

Ilir Deda - Propozoi që të ndërrohet titulli i nenit 17 dhe pika e 2 ku thuhet gjysma e anëtarëve të delegacionit të Kuvendit janë anëtarë të Komisionit për Integrim Evropiane. Ai konsideroi se të gjithë anëtarët e Komisionit për Integrim Evropian duhet të jenë pjesë e Komisionit për Stabilizim Asociim.

Kryetarja shtoi se MSA ka të bëjë një pjesë të madhe me zhvillim ekonomik, tregti e industri andaj duhet me qenë edhe kryetarët e komisioneve të tjera që kanë të bëjnë me MSA-në.

Kryetarja konstatoi se anëtarët u pajtuan që neni 17 të riformulohet si vijon:

Neni 17

Themelimi, përbërja dhe kompetencat e Komisionit Parlamentar të Stabilizim Asociimit

1. Kuvendi, sipas MSA-së do të themelojë Komisionin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit.

2. Anëtarë të delegacionit të Kuvendit në Komisionin Parlamentar të Stabilizim Asocimit do të jenë të gjithë anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian dhe katër kryetarë të Komisioneve Parlamentare përkatëse që kanë të bëjnë me zbatimin e MSA-së.

3. Kompetencat e Komisionit Parlamentar të Stabilizim Asociimit do të caktohen me rregulloren e punës së Komisionit.

Slobodan Petrović - Tha se përveç problemeve në përkthim dhe lektorim që është problem permanent edhe në ligje të tjera, janë edhe disa probleme përmbajtësore që e ndryshojnë përmbajtjen e ligjit dhe kjo është mjaft e komplikuar se janë disa fjalë në gjuhën serbe që unë nuk i kuptoj, mendoj se janë disa pika të tepërta dhe të pa rëndësishme, nuk e di hartuesit a kanë *dashtë* vetëm të kenë numër me të madh të pikave që të duket se kanë punuar diçka.

Të ndryshme

Kryetarja –I njoftoi lidhur me konferencën e cila nuk arriti të jetë rajonale në këtë kohë sepse nga 5 shtetet e ftuara vetëm Maqedonia është përgjigjur, andaj me propozim e të ftuarve është shtyrë për shtator për tu mbajtur në formatin rajonal, për të mos e anashkaluar mbajtjen e një konference, atëherë menduam që nesër të mbahet dhe të ulemi e të diskutojmë për rolin e Kuvendit për Integritet Evropian bashkë me aktorët e tjerë të ftuar dhe të dalim me rekomandime dhe të pregaditemi për konferencë regjionale.

Ilir Deda –Ne jemi marrë vesh që konferenca të mbahet në shtator dhe nuk e di çka është qëllimi i saj dhe kush ka vendosur me u mbajtur kjo konferencë, pse po mbahet dhe për kënd po mbahet? Pse më 16 qershor me u mbajtur konferenca për Integritet evropian kur konferenca të tilla janë mbajtur?

Kryetarja - Tha se konferenca janë mbajtur, por nuk janë mbajtur me Komisionin për Integritet dhe në këtë drejtim ka mjaft zhvillime dhe nëse ne mblidhemi me përfaqësuesit e Qeverisë, kryetarët e komisioneve dhe shoqërinë civile do ta japim njëfarë kontributi për integritet dhe do të kemi mundësi që t'i bashkërendojmë veprimet tona dhe ky është rast i mirë që të diskutojmë.

Ilir Deda - Tha se ne jemi marrë vesh me u mbajtur konferencën për shtator dhe kjo për nesër është vendosur në mënyrë arbitrare, atëherë dua të dijë se nga kush është vendosur dhe kjo është mungesë e kolegjalitetit.

Përgaditi njësi për
Mbështetje komisionit

Kryetare e Komisionit,

Znj. Teuta Sahatqija